

Dënimi me vdekje dhe korrupsioni

[Gazeta Shqiptare, 18.3.2006]

Krimet makabër, ku nuk kursehet as një familje e tërë, as fëmijët, as pleqt, revoltojnë me të drejtë gjithkënd. Sapo ngjanë ndonjë krim i rëndë i radhës, disa e shprehin indinjatën e tyre, me kërkesën e rivendosjes së dënimit me vdekje, jo vetëm si hakmarrje, por si një formë parandaluese e kriminalitetit: “do të tremben nga dënimi, dhe si rezultat do të ulët kriminaliteti,”—mendojnë ata. Duke e mirëkuptuar qëllimin e mirë të kërkuesve për rivendosjen e dënimit me vdekje, ju themi se e kanë krejt gabim: rivendosja e dënimit me vdekje, tek ne, do të sillte rezultatin e kundërt të asaj që shpresohet: nuk do të ulëshin krimet, por vetëm do të shtoheshin paratë e pista që do të merrnin rryshfetxhinjtë e sistemit tonë të drejtësisë, e ç’është më e keqja, do të dënoheshin edhe të pafajshëm, e jo të fajshmit.

Që të keshë dënim me vdekje, duhet të keshë, në radhë të parë, një sistem drejtësie të përkryer, që të mund t’i lësh në dorë jetën e njerëzve. Sistemi i drejtësisë duhet të jetë i aftë profesionalisht dhe i pa korrumpuar. Ka dënim me vdekje në disa shtete të SHBA (Amerikës), por atje, sistemi i tyre i drejtësisë është pafundësisht më i përkryer se yni, si nga aftësia si dhe nga korrupsioni i ulët. Atje, para se të ekzekutohet një i dënuar, kalohet në filtra të një sistemi të tërë institucioneve dhe personash, ku aftësia profesionale është shumë herë më e lartë, dhe ku korrupsioni është me “qindra” herë më i ulët se tek sistemi ynë—ne jemi kampionë të korrupsionit, e prandaj edhe të paaftësisë. Por, nga ana tjetër, jeta e një shqiptari, është po aq e shenjtë, sa jeta e një amerikani. Prandaj, është e rrezikshme të lihet jeta e njeriut, në dorë këtyre tanëve, të këtij farë sistemi drejtësie që kemi ne.

Rritja e rryshfeti për të shpëtuar nga vdekja fajtorin, do të ishte efekti i menjëhershëm i rivendosjes së dënimit me vdekje. Sot, kur ajo që mund të bëjë gjykatësi, është të të ulë disa vjet nga burgu, dhe rryshfetet kanë shkuar me miliona; merreni me mend, se sa do të shkonin rryshfetet, nëse bëhet fjalë për të shpëtuar nga vdekja një kriminel: me siguri do të qindfishoheshin. Rivendosja e dënimit me vdekje, nuk do të trembte fare kriminelët, sepse, përveç të tjerave, ata janë të bindur se në sistemin tonë të drejtësisë, paraja çanë kudo. Civilizimi ynë nuk është akoma i papërgatitur të luftojë sa duhet e si duhet korrupsionin, e këtë e ndjejnë kriminelët: të korrumpuarit e drejtësisë, kanë vila në plazhe, bëjnë pushime jashtë shteti, kanë një luks jete përrallor, e të gjitha këto në sytë e të gjithëve, të secilit prej nesh, dhe në sytë e institucioneve tona të ngarkuara me pastërtinë morale të nëpunësve tanë të drejtësisë. Pra, kriminelët shohin se partnerët e tyre, të korrumpuarit e drejtësisë, jo vetëm se kanë të gjitha të mirat materiale, por kanë edhe respektin e shumicës së shoqërisë sonë, dhe jo së paku të kishin përbuzjen e saj—të ndershmit, shoqëria jonë i shpërblem veç me eufemizmin “qyqari, është i ndershëm”. Këto janë situatat korruptive që bëjnë kriminelin të sigurtë se çdo gjë që shkruhet në ligje, ka pak rëndësi, mjafton të paguhet rryshfeti i duhur personit të duhur. Shoqëria jonë nuk ka nevojë për “ligjin e dënimit me vdekje”, ajo ka nevojë të ketë civilizimin e të zbatojë ato ligje që janë.

Korrupsioni mbjell edhe paaftësinë profesionale, gjë që shpie në dënimin e të pafajshëmve. Gjykatësit, prokurorët e avokatët, nuk synojnë të jenë sa më të ditur, sa më të aftë, që të jenë sa më të kërkuar, sa më të respektuar, sa më të vlerësuar, dhe natyrisht edhe sa më të paguar—gjë që do të ishte më se normale. Nuk është njohja e ligjit, zbatimi i tij profesional, pra dituria, ajo që të bën të respektohesh e të fitosh, në sistemin tonë të drejtësisë. Kjo mungesë e lidhjes dituri-respekt-pasuri, heq incentivë (shtytësa) të fuqishëm njerëzorë, për të qenë të ditur, për të njohur ligjin. Shoqëria jonë ka krijuar incentivë negativë, lidhje negative rryshfet-pasuri-respekt. Shumicës së gjykatësve, apo prokurorëve, apo avokatëve, u duhet diploma e certifikimet e tjera, vetëm sa për të kapur vendin e punës, pastaj janë rryshfetet që përbëjnë të ardhurat kryesore të tyre, dhe edhe burimin e respektit për ta, pra është shkelja e ligjit. Dituria në fushën e njohjes së ligjit, është zëvendësuar me aftësinë për të qenë pjesë e rrjetit të “Monëve” (ndërmjetësve) që lidh njëri me tjetrin gjykatësin-prokurorin-avokatin-kriminelin, duke krijuar kanalin e shpërndarjes së rryshfeteve. Keni dëgjuar kur thonë: ai avokati të kryen punë, jo sepse është i ditur për ligjet, por sepse “është i shkathët, i futur”, ka

lidhje me rrjetin e korrupsionit në drejtësi, di t'i japë rryshfetet. Si rezultat, meqë dituria e ligjit nuk ka vlerë, ajo nuk përdoret, gjë që bën që drejtësia jonë të atrofizohet sa vjen e më tej, përse i përket diturisë, pra po bëhet çdo ditë e më injorante dhe e paaftë. E si mund t'i japim në dorë jetën e njeriut, kësaj drejtësie?! Këta, edhe thjeshtë nga injoranca e tyre, kanë për borxh të dënojnë me vdekje kushedi sa të pafajshëm që nuk kanë para.

Drejtësia jonë do t'i çonte të pafajshmit në botë tjetër, si bedel për fajtorët e vërtetë, në të gjitha rastet kur do t'i duhej t'i vishte krimin e bërë nga klienti i tyre pareli, ndonjë fukarai të shkretë. Nuk ka kufi në poshtërsinë e të korruptuarve që janë edhe injorantë. Veset ushqejnë njeritjetrin: korrupsioni ushqen paaftësinë, paaftësia korrupsionin, duke arritur përmasa Shekspiriane.

Në këtë shkrim, nuk u morëm me qindra arsye të tjera që janë kundër dënimit me vdekje, e që janë trajtuar në miliona faqe të mendimit botëror, e që kanë bërë që të hiqet nga të gjithë shtetet evropiane perëndimore. Nuk kishim pse “të gjenim shkaqe të tjera se përse nuk bie këmbana, derisa mjafton shkaku i vetëm: nuk ka këmbanë”—nuk kemi pra drejtësi, për t'i lënë në dorë “dënimin me vdekje”, prandaj edhe nuk duhet të bëjmë gabimin naiv që të rivendosim dënimin me vdekje.

Bashkim Kopliku

Durrës, më 21.2.2006